



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KESHILLI KOMBETAR I UJIT
Keshilli I Basenit Ujembledhes Mat

V E N D I M

Nr.05/02 Date 17/06/ 2010

Per

**Rinovimin e Lejes Shfrytezimit te Inerteve nr.01 date 30.05.2007 per Subjektin
"Rafaelo 2000" shpk**

Ne mbeshtetje te neneve 8,14,20 te ligjit nr.8093 dt. 21.03.1996 "Per Rezervat Ujore" dhe te vendimit nr. 3 date 09.01.2003 te Keshillit Kombetar te Ujit "Mbi procedurat e dhenies dhe te rinovimit te lejeve per shfrytezimin e zhavorreve dhe rerave nga shtreterit e lumenjeve", AUB Mat pervec sqarimeve per kete subjekt lexoi edhe V.KKUJit nr.01.dt 13.01.2010 per ndalimin e dhenies se lejeve te reja per shfrytezim te inerteve, ku mbas diskutimeve, **Keshilli i Basenit Ujembledhes Mat,**

V e n d o s i:

- 1.Miratimin e Rinovimit te lejes per shfrytezim inertesh ne shtratin e lumit Mat **Subjektit "Rafaelo 2000" shpk.** Ky vendim eshte eshte i vlefshem ne se bashkangjitur atij eshte *procesverbali me AUB per vendosjen e reperave dhe vertetimi i pushtetit vendor per shlyerjen e detyrimeve dhe per pemet e mbjellura sipas studimit.*
2. Siperfaqja e shfrytezimit $S=0,075$ km².
3. Kordinatat e zones se shfrytezimit jane si me poshte:

Pikat	x	y
1.	4616185	4388117
2.	4617145	4387953
3.	4617197	4388054
4.	4616432,5	4388218

4. Volumi i parashikuar per shfrytezim $v=40000$ m³/vit.
5. Kushtet per reabilitim te zones afer karrieres, reperizimin dhe shfrytezimin duke filluar nga aksi i lumit sipas vendimit nr.06 dt.17.06.2010 bashkangjitur ketij vendimi vlejne edhe per subjektin "Rafaelo 2000".
6. Ky vendim ka vlefshmerine per te vazhduar Leja e Shfrytezimit me afat 5-vjecar sipas kerkeses se firmes "Rafaelo 2000" shpk dhe hyn ne fuqi menjehere mbasi te jete informuar Ministria e Mjedisit Pyjeve dhe administrimit te Ujrave Tirane.

PERGJEGJESI I A.U.B. MAT
Pashk NDOCI



KRYETARI I K.B.U. MAT
Pal DAJCI

